

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ARTING" SHPK

Sot më datën 16.04.1996 (nëntëdhjetë e gjashtë), i nënshkruari Ar= tur Bajram Berberi, me banim në lagjen nr.1, rruga " Shemshi Koroveshi", shtëpia nr. 29 Pogradec, me letër njoftimi QH Nr 150988, me vullnetin e tij të lirë e të plotë, vendosi të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " ARTING" SHPK Pogradec.

neni 1

I lart përmenduri në këtë akt shpreh vullnetin e tij të lirë për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, veprim ky që mundëson ~~xxx~~ zhvillimin e kativitetit të tij prodhues e tregëtar në të gjithë teritori e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: 1) Prodhim dhe tre= gëtim bukësh; 2) Shërbime të ndryshme në mekanikë; 3) Tregëtim artikuj industrialë, ushqimorë, materiale ndërtimi, makineri e pajisje, pjesë kë= =bimi import - eksport".

neni 3

Kapitali fillestar që do të investohet nga ortakut i vetëm Artur Ber= beri është 100.000 lekë (njëqint mijë).

neni 4

Afati i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë 11 vjet (mbi 10 vjet), që fillon më 16 prill 1996 deri më 16 prill 2007.

neni 5

Emërtimi i shoqërisë do të jetë "ARTING" SHPK Pogradec.

neni 6

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

neni 7

Të ardhurat që do të përfitohen nga ortakut i vetëm, pasi të shlyejë të gjitha detyrimet fiskale dhe ndaj të tretëve, mbeten pasuri e tij.

neni 8

Administrator i shoqërisë do të jetë Zoti BUJAR SHEFKI MUÇO i cili mer edhe atributet e drejtimit të shoqërisë? Lagja 5, Rr. "Unezë", P.75 Pog= =radec.

neni 9

Veprimtaria e shoqërisë do të zhvillohet në rrethin e Pogradecit si dhe në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Selia (qendra) e shoqërisë do të jetë qyteti i Pogradecit, me adresë "Lagja nr. 1, rruga " Shemshi Koroveshi", shtëpia nr. 29 Pogradec.

neni 10

Ortakut i vetëm ra dakord që llogarinë rrjedhëse ta ketë në Degën e Bankës Komëtare tregëtare Pogradec.

neni 11

Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm, organizimi i shoqërisë

dhe marrëdhëniet me personat juridikë e fizikë, vëndas apo të huaj si dhe me shtetin, shprehen në statut, akt i cili së bashku me aktin e themelimit, përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë së saj dhe shërbejnë për regullimin e marrëdhënieve në këtë fushë.

neni 12

Shoqëria ka të drejtë të marrë në punë punonjës të specialiteteve të ndryshme për të plotësuar nevojat e saj, me të cilët detyrohet të lidhë kontratë individuale, me grup personash si dhe kontratën kolektive me Këshillin e mundshëm sindikal.

neni 13

Shoqëria "ARTING" SHPK e ka qendër në qytetin e Pogradecit, por aktiviteti i saj do të shtihet në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

neni 14

Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme, me personat juridikë e fizikë vëndas apo të huaj si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim. Me anë të dispozitave të këtij akt themelimi, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat, mosmarrëveshjet zgjidhen nga gjykata.

neni 15

Akti i themelimit të shoqërisë redaktohet në disa kopje, lexohet nga ortaku i vetëm dhe pasi shprehet dakord me përmbajtjen e tij, nënshkruhet regullisht.

Pogradec më 16.04.1996

ORTAKU I VETËM THEMELUES
(ARTUR BAJRAM BERBERI)

AVOKAT
Ligor
Pog

Nr. 1154 Rep

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA POGRADEC
NOTERE ANILA PETROVSKI

VERTEPIM NËNESHKRIMI
Sot më datën 16.04.1996 (nëntëdhjetë e gjashtë), para meje notere Anila Petrovski u paraqit personalisht Artur Bajram Berberi, me dt. lindje 15.12.1966, me banim në lagjen nr. 1, rruga " Shemshi Koroveshi", shtëpia nr; 29 Pogradec, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurua nga letër njoftimi personal, i cili deklaroi se sa më sipër është një Akt themelimi i redaktuar jashtë kësaj zyre, me vullnetin e tij të lirë e të plotë, me përmbajtjen e të cilit ishte dakord dhe e nënshkroi etë regullisht.

N O T E R E

ANILA PETROVSKI



S T A T U T I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ARTING" SHPK POGRADEC

KREU I I^{re}

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ARTING" SHPK Pogradec, është pronë e ortakut të vetëm z. Artur Bajram Berberi, me shtetësi shqiptare.

neni 2

Shoqëria "ARTING" SHPK është person juridik shqiptar. Ajo fiton të drejtën e personit juridik nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Gjykatës të rrethit Tiranë.

neni 3

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj prodhuese e tregëtare në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj.

neni 4

Shoqëria "ARTING" SHPK Pogradec krijohet për të ushtruar veprimtari në e saj prodhuese dhe tregëtare për një periudhë 11 vjeçare, nga viti 1996 deri në vitin 2007.

Qendra (Selia) e shoqërisë është qyteti i Pogradecit.

Kapitali themeltar i shoqërisë në vlerë është 100.000 lekë.

neni 5

Shoqëria krijohet për të realizuar veprimtarinë e saj në: 1) Prodhim dhe tregëtim bukësh; 2) Shërbime të ndryshme në mekanikë; 3) Tregëtim artikuj industrialë, ushqimorë, materiale ndërtimi, makineri e pajisje, pjesë këmbimi import-eksport".

neni 6

Shoqëria ka të drejtë të çelë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të vendeve ku ato do të hapen.

neni 7

Shoqëria përgjigjet me fondet e veta për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet me të tretët.

neni 8

Në bazë të ligjës, kapitali fillestar është depozituar në Degën e Bankës kombëtare tregëtare Pogradec.

neni 9

Person përgjegjës për themelimin e shoqërisë "ARTING" SHPK Pogradec është ortaku i vetëm themelues ARTUR BERBERI.

KREU I II

MARRËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE

neni 10

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike

%



dhe pasqyrohet në bilançet e saj.

neni 11

Kapitali themeltar i shoqërisë është burimi fillestar për krijimin e fondeve të veçanta dhe të mjeteve të xhiros.

Në rast se shoqëria do të rritë numurin e pjesëmarrësve me ortakë të rinj, ata detyrohen që brenda tetë ditëve nga data e nënshkrimit të aktit të marrëveshjes, të likuidojnë kuotat e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, si ortakë të rinjë bë bëhen.

Në rastin e likuidimit të kuotës sejcili ortak do të regjistrohet në librin përkatës të shoqërisë si dhe do t'i jepet një vërtetim i nënshkruar nga administratori i shoqërisë z. Bujar Muço, me anë të të cilës vërtetohet likuidimi i kuotës.

neni 12

Brenda gjashtë muajve nga data e likuidimit të kuotave, është i detyrueshëm përfundimi i krijimit të përfundimit të shoqërisë, në të kundërtën sejcili ortak; veçanësisht ose të gjithë sëbashku të përfaqësuar nga një i zgjedhur prej tyre ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë tërheqjen e kuotës për likuidimin e kapitalit themeltar.

neni 13

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen detyrimet ndaj të tretëve, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave ja u ndan ortakëve në përpjestim të drejtë me kuotat e depozituesve për krijimin e kapitalit themeltar.

neni 14

Shoqëria ka të drejtë të posedojë, gëzojë dhe disponojë pasurinë e saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria gëzon të drejtën e mbrojtjes së pasurisë që ajo ka në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

neni 15

Shoqëria, me fondet rezervë dhe fondet e tjera të veçanta ka të drejtë të kryejë lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike, financiare dhe tregëtare me persona fizikë e juridikë, shqiptarë apo të huaj. Përbërje, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondeve rezervë dhe atyre të veçanta, përdorimi dhe regullimi i tyre, vendoset nga orteku i vetëm ose ortakët e mundshëm.

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët, mbulohen me fondet rezervë dhe fondet e tjera të veçanta ose me shuma suplementare që mund të derdhen në kapitalin themeltar, kur ato detyrime nuk është mundur të shlyhen me fondet ekzistuese.

neni 16

Shoqëria sipas mundësive të saj, ka mundësi të investojë nga kapitali i vet, tek persona juridikë shtetërorë dhe privatë, si dhe persona juridikë të huaj. Fitimi që realizohet nga ushtrimi i veprimtarisë prodhuese dhe tregëtare, konvertohet në valutë sipas rregullave në fuqi. Ai mund të transferohet pa asnjë pengesë jashtë vëndit.

neni 17

Pasuria e shoqërisë pasqyrohet në bilançin e saj me vlera të shprehura në monedhë shqiptare ose të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Bilançi mbahet nga shoqëria sipas ligjit nr.7661 datë 19.I.1993 "Për kontabilitetin".

Bilançi vjetor të vitit të parë të veprimtarisë së shoqërisë, pasqyrohet brenda muajit mars të vitit pasardhës dhe po kështu vepohet çdo vit. Bilançi vjetor mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti kontabël i ngarkuar për këtë qëllim. Ekspert kontabël caktohet nga ortakët dhe kur këta nuk bien dakord, caktohet nga Gjykata e cila përcakton edhe shpërblimin për të.

neni 18

Veprimtaria financiare mbështet në aktivin dhe pasivin, të cilat pasqyrohen detyrimisht në bilanç.

Rezultatet financiare të veprimtarisë së shoqërisë përcaktohen në bazë të bilançit vjetor.

neni 19

Shoqëria ka të drejtë që për të shlyer detyrimet ndaj të tretëve të lënë peng pjesë të kapitalit themeltar. Në rast të shitjes së detyruar të pjesës së lënë peng, pengmarësi do të barazohet me personin që i transferohet pjesë e kapitalit, me përjashtim të rastit kur është rënë dakord me pengmarësin për ta riblerë atë.

neni 20

Kuotat e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar janë të transferueshme në favor të të tretëve, ndërmjet ortakëve si dhe në favor të trashëgimtarëve.

neni 21

Paga e të punësuarve caktohet në përputhje me treguesit ekonomike-financiare të shoqërisë. Në përputhje me kushtet konkrete shpërblimi për punën e kryer mund të jetë orare, ditore, javore, dy javore ose mujore.

neni 22

Marrëdhëniet e punës me të punësuarit në shoqëri rregullohen me kontratë pune individuale, grup punonjësish si dhe me anë të kontratës kolektive, në bazë të ligjit nr 7961 datë 12.7.1995.

KREU I III
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

neni 23

Drejtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ARTING" SHPK bëhet nga administratori i shoqërisë z. Bujar Muço, me adresë, Lagja 5, Rr. "Unazë" P.75 Pogradec.

Z. Artur Berberi, si ortak i vetëm i shoqërisë vendos për bilancin vjetor, ndryshimet në statut, për shtimin ose pakësimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, për likuidimin e shumave shtesë në kapitalin themeltar, për caktimin e kespertëve kontabël, për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë si dhe për ndryshimin e formës së shoqërisë.

Administrator i shoqërisë "ARTING" SHPK Pogradec është zoti Bujar Muço.

neni 25

Në rast se do të ritet numuri i ortakëve të shoqërisë, organi vendimor i shoqërisë do të jetë asamblea e ortakëve në të cilën marrin pjesë të gjithë ortakët.

neni 26

Asamblea e ortakëve, për mbledhjen e saj të zakonshme apo të jashtëzakonshme thirret nga administratori me letër rekomande të paktën 15 ditë përpara mbledhjes. Në njoftim bëhet e ditur data, ora dhe vendi i mbledhjes. Në rast se mbledhja mund të jetë edhe jashtë selisë së shoqërisë. Së bashku me njoftimin e mbledhjes u bën të njohur ortakëve dhe rendin e ditës së mbledhjes.

neni 27

Mbledhja e zakonshme e asamblesë bëhet një herë në vit, por jo më von se katër muaj pas mbylljes së bilancit vjetor dhe për shkak të përparësive mund të shtyhet edhe një muaj.

neni 28

Mbledhja e jashtëzakonshme mund të organizohet për ndryshim në aktin e krijimit të shoqërisë, në statut si dhe për organizimin e shoqërisë.

neni 29

Vendimet e marra në mbledhjet e zakonshme apo të jashtëzakonshme vërtetohet me proces verbal të nënshkruar nga administratori.

neni 30

E drejta e firmës dhe e përfaqësimit të shoqërisë i përket administratorit.

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe kryhen të gjitha veprimet administrative në interes të saj.

KREU I IV^{të}

ORGANIZIMI DHE PUSHIMI I VEPRIMTARISË

neni 31

Riorganizimi i shoqërisë, sipas kushteve të përcaktuara në ligj, bëhet nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat pjesë së kapitalit themeltar.

neni 32

Veprimtarisë e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar nga dispozitat e më sipërme. Ajp mund të pushojë veprimtarinë kur shoqë-

ria nuk realizon fitimin ose kur vendoset nga asamblea e ortakëve me unanimitet.

neni 33

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, caktohet një grup ekspertësh të cilët përgetisin raportin kontabël dhe ja paraqesin për shqyrtim ortakëve ose asamblesë së ortakëve në rast të shtimit të tyre. Shoqëria ndërpret veprimtarinë në qastin e miratimit të raportit kontabël të paraqitur nga ekspertët. Në këtë rast shlyehen detyrimet ndaj të tretëve dhe bëhet ndarja e fitimit. ~~xx~~

neni 34

Kur pushon veprimtarinë një filial, degë apo egjensi, ose ato riorganizohen, do të vepronhet një lloj si në rastin e shoqërisë.

neni 35

Mosmarëveshjet e shoqërisë në marrëdhënie me personajuridikë e fizikë vëdas apo të huaj, zgjidhen me mirëkuptim; Me anë të dispozitave të këtij statuti, aktit të themelimit dhe legjisllacionit shqiptar, kryesisht ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 .kur mjete emë sipërme nuk japin rezultat mosmarëveshjet zgjidhen nga Gjykata e rrethit Pogradec.

neni 36

Për sa nuk është shprehur në statut, t'i referohet ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " dhe çdo akti tjetër të legjisllacionit shqiptar.

neni 37

Statuti përpilohet në disa kopje ,për t'iu dorëzuar organve kompetente. Një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " ARTING "SHPK Pogradec.

U nënshkrua sot në Pogradec më 16 prill 1996

ORTAKU I VETËM THEMELUES
ARTUR BAJRAM BERBERI

AVOKAT
Ligor Nole
Pogradec

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
NOTERIA POGRADEC
NOTERE ANILA PETROVSKI

Nr. 1159 . Rep.

VERTEJIM NËNËSHKRIMI

Sot më datën 16 prill 1996 (nëntëdhjetë e gjashtë) para meje notere Anila Petrovski u paraqit personalisht zoti; Artur Bajram Berberi, me dt lindje 15/12/1966, me banim në lagjen nr. 1 Pogradec, rrugë "Shemshi Koroveshi", shtëpia nr; 29 Pogradec, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i panjohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurova nga një letër njoftimi persobël, i cili deklaroi se sa më sipër është një Statut, i redaktuar jashtë kësaj zyre ,me vullnetin e tij të lirë e të plotë, me përmbajtjen e të cilit ishte dakord dhe e nënshkroi atë regullisht. -----

N O T E R E
(ANILA PETROVSKI)

